



30-04-25  
14-024/21-59748/25

REPUBLIKË E KOSOVËS  
NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.  
MPE REGISTRATION I S.  
08/660 Data 30-04-2025



**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT**

**NDËRMJET**

**KRYEQYTETIT**

**DHE**

**NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A**

**Prill 2025**



**Palët nënshkruese:**

1. **Kryeqyteti i Republikës së Kosovës, Prishtina** me seli/adresa: Rr. UÇK nr.2, 10000 Prishtinë, e përfaqësuar nga Përparim Rama, Kryetar *dhe*,
2. **NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A**, të cilën e përfaqëson z. Veton Prelvukaj, U.D. Kryeshef ekzekutiv.

### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit lidhet ndërmjet Kryeqytetit dhe NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A me qëllim të përkrahjes, rritjes së frymës së bashkëpunimit ndërmjet palëve nënshkruese dhe realizimit të objektivave të përbashkëta.

### **Neni 2 Përgjegjësitë e palëve**

1. **Kryeqyteti i Republikës së Kosovës, Prishtina**, zotohet që do të investoj në hapësirat e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A, respektivisht në:
  - Ndriçimin e hapësirave të ndërmarrjes;
  - Investim në hapësirat gjelbëruese të ndërmarrjes;
  - Investim në një kënd të lojrave për fëmijë në hapësirat e ndërmarrjes.
2. **NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A**, zotohet se do të fus në sistem dhe implementoj shërbimin e biletës së integruar të transportit publik urban.

### **Neni 3 Vullneti i lirë i palëve**

Palët deklarojnë se këtë Marrëveshje e lidhin me vullnet të lirë.

### **Neni 4 Mosmarrëveshjet**

Çdo kontest apo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, do të zgjidhet me negociata dhe në frymë bashkëpunimi.



**Neni 5**  
**Të ndryshme**

Marrëdhëniet ndërmjet palëve lidhur me çështjet që nuk janë përfshirë në këtë Marrëveshje, do të rregullohen në bazë të ligjeve të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

**Neni 6**  
**Kopjet origjinale**

Kjo Marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje origjinale, ku secila palë merr nga një (1) kopje origjinale.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

E nënshkruar në Prishtinë, me datë 30/04/2025.

Përparim Rama

Kryetar  
Kryeqyteti



Veton Preljokaj

U.D. Kryeshf ekzekutiv  
NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A

